



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 23.

Prishtinë, më 10.11.2015 në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković, Mufera Sinik, Agim Kikaj, Milka Vuletić, Sasha Milosavljević, Slavko Simić, Çerim Bajrami, Danush Ademi dhe Veton Berisha .

Munguan: Agim Çeku, Fisnik Ismaili dhe Rustem Berisha.

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhje : Ardiana Gashi, përfaqësues nga OSBE-ja, Melina Muriq-RTK, Albana Bajrami-RTK , Ismail Shabani- Kosova Pres, Artan Murati, përfaqësues i KAAD dhe Celal Iliaz-përfaqësues i mediave nga Kuvendi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma, koordinatore dhe Drita Çarkaxhiu, zyrtare e lartë ligjore.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Zhivković**, kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më datën 21.9.2015, 30.9.2015 dhe 13.10.2015;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-18 për Provimin e Maturës Shtetërore, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Myfera Sinik, propozoi që rendi i ditës të plotësohet me pikën, verifikimi i diplomave para vitit 1999.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni miratoi rendin e ditës me propozimin e lartcekur.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.9.2015, 30.9. 2015 dhe 13.10.2015;

Kryesuesja, konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 21.9.2015, 30.9.2015 dhe 13.10.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet, me amendamente të Komisionit Funksional për Buxhet dhe Financa;

Kryesuesja, paraqet për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L-045 për Sigurimet dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohet, nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin, i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Meqë nuk pati vërejtje në Projektligj dhe pas shqyrtimit të raportit me amendament të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-045 për Sigurimet dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit me amendamente të Komisionit Funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin nr.05/L-042, për rregullimin e shërbimeve të ujit me Raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Meqë nuk pati vërejtje në Projektligj dhe pas shqyrtimit të raportit me amendament të Komisionit Funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin nr.05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-18 për Provimin e Maturës Shtetërore, me amendamente të Komisionit Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin nr.05/L-18, për Provimin e Maturës Shtetërore me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohen nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin, i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Muferra Sinik, diskutoi për procedurat të cilat duhet t'ju përmbahen studentët në hyrje të provimit të maturës shtetërore. Ajo propozoi që neni 5, pika 1, të definohet si në vijim: Kandidati i nënshtrohet provimit të maturës shtetërore në njërin nga gjuhët zyrtare në Kosovë, sipas 'Ligjit të Arsimit

parauniversitar' dhe në vazhdimësi të mbetet Ligji për përdorimin e gjuhëve. Ajo kërkoi që ky propozim të dalë si amendament i komisionit .

Si anëtare e Komisionit për Arsim, në disa takime ka dalë me kërkesë që të ndryshohet neni 8, me propozim që ministri të emërojë Komisionin Shtetëror të Maturës, duke pasur parasysh barazinë gjinore dhe etnike dhe është miratuar ky propozim. Mirëpo, nuk është ndryshuar përbërja e komisionit dhe kërkoi që prej 9 anëtarëve të komuniteti shqiptar, 2 anëtarë të zgjidhen nga komunitetet jo shumicë.

Veton Berisha, tha se vjen nga një konferencë ku janë bërë hulumtime nga studentë, me temën: dhënia e provimit të maturës shtetërore. Nga takimi dolën me disa propozime konkrete, siç janë, heqja e pagesës, nxënësit të cilët nuk dëshirojnë të vazhdojnë studimet kanë të drejtë të marrin diplomën, kandidatët të cilët dëshirojnë të vazhdojnë studimet në nivel universitar, janë të obliguar ti nënshtrohen provimit të maturës shtetërore. Berisha tha se këto propozime janë shumë të mira ngase do të arrihet ngritja cilësore e nivelit , siç e kanë edhe vendet në rajon.

Berisha u pajtua me propozimin e Myfera Shinik , lidhur me emërimin e Komisionit Shtetëror të Maturës për barazi etnike dhe gjinore, mirëpo, kërkoi që për emërimin e anëtarëve të përcaktohet cilësia, e cila ka një rëndësi të veçantë për arritjen e rezultateve të duhura.

Ai përkrahi miratimin e projektligjit dhe rekomandimet e Komisionit Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

Qerim Bajrami, përkrahu propozimin e koleges Mufera dhe njëherësh kërkoi që prej 12 anëtarëve të Këshillit, më së paku 2 të jenë përfaqësues nga komuniteti jo shumicë, duke dhënë shpjegime se zakonisht një vend ndahet për përfaqësues të komunitetit serb dhe një vend përcaktohet për komunitetet tjera.

Më pas, ai foli për nenin 5, të projektligjit dhe propozoi që pas fjalës “ të drejtat e kandidatëve të cilët i nënshtrohen provimit të maturës shtetërore, në njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë”, të shtohet ‘Ligji i arsimit parauniversitar’ dhe të mbetet Ligji për përdorimin e gjuhëve.

Danush Ademi, propozoi që prej 12 anëtarëve të Këshillit, të rritet numri në tre anëtarë, të jenë të zgjedhur nga komunitetet tjera, në proporcion, një anëtar të zgjidhet nga komuniteti serb, një nga komuniteti boshnjak apo turk dhe i treti nga përkatësia e komunitetit rom, ashkali apo egjiptian. Ai shtoi se në shumë raste shkelen të drejtat e komunitetit pakicë, andaj, nëse është nevoja do të ndryshohet projektligji.

Agim Kikaj, tha se me propozimet e dhëna për ndryshimin e strukturës së këshillit, duhet të jemi të përgjegjshëm dhe të kemi kujdes sepse mund të bimë në kundërshtim me ligjet, të cilat janë në fuqi dhe me Kushtetutën.

Sasha Milosavleviq, theksoi se të gjitha propozimet që dalin nga ne, duhet të jenë në harmoni me veprimtarinë e komisionit dhe që të reagohej në mënyrë adekuate. Nëse ka mundësi të zgjidhen tre anëtarë, sipas propozimit të Danushit, dhe e përkrahi këtë propozim. Mirëpo, nëse me amendamente do të definohet përcaktimi i komunitetit, del se nuk do të jetë në harmoni me projektligjin.

Pas diskutimeve të anëtarëve, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin dhe Raportin me amendament të Komisionit Funksional dhe nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni shqyrtoi Projektligjin për Provimin e Maturës Shtetërore me amendamentet e propozuara të Komisionit Funksional dhe konstatoi se të njëjtat dispozita nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Rekomandohet propozimi me plotësim:

Amandamenti 1

Neni 5. paragrafi 1

Në rreshtin e parë, pas fjalës “të drejtat e kandidatëve të cilët i nënshtrohen provimit të maturës shtetërore në njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë, të shtohet “sipas Ligjit të Arsimit parauniversitar” dhe Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

6. Të ndryshme .

Kryesuesja, fjalën ia dha Myfera Shinik për të dhënë sqarime lidhur me temën e verifikimit të diplomave universitare, para vitit 1999.

Myfera Sinik, theksoi se duhet të procedohet çështja e verifikimit të diplomave për studentët, të cilët kanë kryer fakultetin para vitit 1999, me qëllim që t’ju mundësohet **kyçja** (inkuadrimi) në shoqërinë kosovare.

Pas diskutimeve të anëtarëve u mor qëndrim që znj. Myfera të sjellë me shkrim propozimin e lartcekur, më pas komisioni do ta shqyrtojë dhe procedojë në institucionet relevante.

Veton Berisha, tha se sa i përket çështjes së regjistrimit të kandidatëve të komunitetit jo shumicë, rezulton një numër i konsiderueshëm të studentëve, të cilët nuk janë regjistruar në nivel universitar dhe kjo çështje kërkon zgjidhje të përhershme e jo të njëjtat të përsëriten çdo vit. Ai, propozoi që komisioni të përsërisë ftesën për ministrin z.Arsim Bajrami dhe rektorin z. Ramadan Zejnullahu, që të informojnë lidhur me shpalljen e konkursit plotësues për regjistrim të studentëve që i përkasin komunitetit jo shumicë.

Vërejtje pati edhe nga **Qerim Bajrami** dhe **Danush Ademi**, lidhur me situatën e krijuar për shpalljen e konkursit plotësues nga ana e Rektoratit i UP-së, të cilët e konsiderojnë se ka shkelje procedurale, ngase konkursi nuk është dashtë të shpallet i njëanshëm, vetëm për kategorinë me benificione nga regjioni, por të planifikohet ekskluzivisht edhe për pjesëtarët e komunitetit jo shumicë si qytetarë të Republikës së Kosovës. Ndër të tjera, u diskutua se një numër i konsiderueshëm i studentëve e kanë arritur kuotën e përcaktuar, mirëpo, shumica prej tyre kanë mbetur jashtë dyerve të fakulteteve. Kjo dëshmon se në programet ku janë garantuar 328 vendet të lira, janë pranuar vetëm 10% studentë të komunitetit jo shumicë

Pas diskutimeve, Komisioni për të drejtat, interesat e komuniteteve dhe kthim, nxori këtë:

Përfundim

Me pajtim të anëtarëve të Komisionit, u mor qëndrim që në afat sa më të afërt të ftohet në takim ministri z.Arsim Bajrami dhe rektori z. Ramadan Zejnullahu, për të raportuar lidhur me mundësinë e shpalljes së konkursit plotësues, për regjistrimin e studentëve të komunitetit jo shumicë, në vitin akademik 2015/16.

Veton Berisha, lidhur me monitorimin e Ligjit për Shërbimin Civil, gjegjësisht neni 11, si kërkesë të tij paraqiti që në njërën nga mbledhjet e komisionit të ftohet ministri i MAP-it, z.Mahir Jagcilar, për të raportuar lidhur me numrin e të punësuarve në shërbimin publik dhe privat dhe në fazën e fundit do të vizitohet Komuna e Pejës. Pas përfundimit të këtyre fazave, grupi punues, do ta hartojë draft-raportin dhe të njëjtin do ta paraqes për shqyrtim në komision, kurse më pas, do të procedohet për miratim në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Jasmina Zhivković